



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:918568  
Datë: 15.03.2024  
Numri i dokumentit: 06157590

C. nr. 1510/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit Xh.L. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson S.K. avokat nga Lipjani, kundër të paditurës N.T.SH "B.R.", në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson V.O. avokat nga Prizreni, për kompensimin e dëmit, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor, me datë 01 Mars 2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Miratohet kërkesëpadia e paditësit Xh.L. nga Prizreni.

Detyrohet e paditura N.T.P. "B.R." me seli në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit në emër të fitimit të humbur shumën 9.182,75 €. Ndërsa në emër të kontributit pensioanl për paditësin Xh.L. të paguan shumën 790,80 €, shumëne tjetër prej 198.10 € për paditësin Xh.L. ta paguan në Administratën Tatimore. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nënë kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Xh.L. në padinë e paraqitur me datë 01.06.2012, përmes të autorizuarit të vet, kundër të paditurës N.P.T. "B.R." për kompensim dëmi, ka kërkuar nga gjykata miratimin e kërkesëpadiës, duke kërkuar të kompensohet për dëmin material dhe jomaterial.

Gjykata pjesërisht ka miratuar kërkesën e palës paditëse ashtu që e ka detyruar të paditurën që në emër të dëmit material dhe jomaterial t'i kompensohet shumën si në dispozitivin e aktgjykimit C. nr. 554/2012 datë 07 Shtator 2016.

Gjykata e Apelit pjesërisht ka vërtetuar këtë aktgjykim ashtu që për pjesën lidhur me fitimin e humbur e ka prishur lëndën dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Pala e paditur ka parashtruar revizion duke i sulmuar vendimet e shkallës së parë dhe të dytë. Ndërsa për pjesën lidhur me fitimin e humbur, atë pjesë nuk e ka sulmuar. Ashtu që Gjykata Supreme për atë pjesë ka konstatuar se Revizioni është i palejueshëm pasi që pasi që nuk ka pasur pretendim nga pala e paditur dhe kjo çështje nuk ka qenë objekt shqyrtimi.

Gjatë seancave i autorizuari i paditësit ka ngelur në tersi si në theksimet e deritashme, në lëndën e cila tashë më është kthyer në rigjykim. Sqaron që gjykata e shkallës së parë tash në rivendosje duhet pasur parasysh konstatimet e Gjykatës Supreme e cila ka konstatuar përgjegjësin e palës së paditur në kompensimin e dëmit, e gjithashtu edhe konstatimin që shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë kanë qenë në përputhje me dëmin e shkaktuar.

Gjithashtu sqaron që sa i përket kohës së kompensimit të fitimit të humbur dhe shumës së kompensimit gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si për kohen e po ashtu

edhe shumë duke pasur parasysh se ajo kohë është llogaritur nga data kur paditësi është lënduar dhe nuk ka mundur të punon deri me datën kur paditësi pas shërimit ka gjetur punë. Ndërsa sa i përket shumë, ajo është llogaritur nga eksperti aktuar duke pasur parasysh faktin e shumë më të ulët që paguhet profesioni i shoferit të autobusit.

Ka propozuar miratimin e kërkesëpadisë. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë në shumën 552.56 dhe atë nga 135,20 € për seancë gjithsejtë për 4 seanca të mbajtura nga 235,20 € dhe 11.76 € për shpenzimet e udhëtimit.

E paditura përmes të autorizuarit të sajë e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë sa i përket fitimit të humbur. Sqaron që koha për të cilën kërkon fitimin e humbur me asnjë provë nuk është provuar që pasi që pala paditëse nuk ka paraqitur ndonjë kontratë pune me afat të pacaktuar dhe gjykata të përfill rekomandimin gjykatës së Apelit.

Propozon refuzimin e kërkesëpadisë. I kërkon shpenzimet e procedurës në shumën 540,00 € he atë për 4 seanca të mbajtura, për secilën seancë nga 135,00 €.

Gjykata me qellim të vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike, ftoi ekspertin aktuar në seancë i cili edhe niher shtjelloi ekspertizën e paraqitur me datë 27.04.2015 për të sqaruar kërkesat e Gjykatës së Apelit lidhur me fitimin e humbur.

Nga administrimi i kësaj prove dhe dëgjimi i ekspertit gjykata vërtetoi që shuma e kompensimit të fitimit të humbur është 9.182,75 € si dhe 790,80 € është detyrimi që pala e paditur duhet të paguan për paditësin si kontribute pesnionale dhe 198,00 € të paguan për paditësin në administratën tatimore.

Nga kjo provë e administruar dhe procedimi i çështjes, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e fitimit të humbur është e bazuar.

Në kuptim të nenit 173 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (G.Z. RSFJ), dëmi mund të shkaktohet edhe nga sendi i rrezikshëm. Ndërsa në kuptim të nenit 174 të po këtij ligji, përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm është pronari i atij sendi. Pra në këtë rastë pavarësisht nga faji, pronari i atij sendi përgjigjet në bazë të përgjegjësisë objektive. Në rastin konkret qeni ka qenë pronë e të paditurës N.T.SH "B.R.", në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit, ashtu që përgjegjësia, pavarësisht fajit, i takon të paditurës N.T.SH "B.R.", në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit nga baza e përgjegjësisë objektive si pronare e qenit.

Në kuptim të nenit 189 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (G.Z. RSFJ) i dëmtuari përveç dëmit të thejsht ka të drejtë të kompensimit edhe për fitimin e humbur.

Fitimi i humbur përcaktohet si pengim i rritjes së pasurisë. Me këtë duhet nënkuptuar fitimi të cilin i dëmtuari e pret sipas rrjedhës normale të gjërave dhe të cilin do ta realizonte, sikur të mos ndodhte ngjarja dëmtuese. Për të ekzistuar fitimi i humbur dhe për të pasur të drejtën e shpërblimit, është e nevojshme që, me rastin e caktimit të masës së tij, të merret parasysh fitimi që mund të pritët sipas rrjedhës normale të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, realizimi i të cilit është penguar, në rastin konkretë me veprimin e shkaktuesit të dëmit. Në rastin konkretë lëndimet që ka marr paditësi nga qeni i të paditurës, kan shkaktuar pasoja të përkohshme në aftësin punuese të paditësit. Gjykata edhe njëherë vlerëson që kohyngjatja e fitimit të humbur ka qenë nga koha e shkaktimit të paafhtësisë për punë, data 01.10.2011 deri në kohën kur paditësi ka gjetur punë. Për këtë kohë gjykata ka urdhëruar ekspertit të llogaritë fitimin e humbur.

Gjykata ka vlerësuar rekomandimet e Gjykatës së Apelit që gjykata është dashur të merr parasysh kohën kur kanë pushuar pasojat e paaftësisë për punë pra nga data e lëndimit deri sa paditësi ishte i paaft për punë, e jo deri sa të gjenë punë.

Gjykata konsideron që ky konstatimi gjykatës së Apelit nuk mund të qëndron, nga fakti që para se paditësi të sulmohej nga qeni dhe të bëhet i paaft për punë, ai ka qenë duke punuar si vozitës tek e paditura. Që nga data e sulmit e deri me datën kur paditësi ka gjetur punë i njëjti ka pësuar fitim të humbur pasi që njëherë nuk ka mundur të punon sepse ka qenë i paaft për punë, ndërsa më vonë pavarësisht se kanë pushuar pasojat paaftësisë për punë, nuk ka mundur të gjen punë. Ashtu që gjykata gjen që për të gjithë kohen nga sulmi i qenit e deri në ditën kur ka gjetur punë, paditësi ka pasur fitim të humbur. Sulmi nga qeni ka qenë shkaktar që paditësi për atë kohë të mos mund të krijon të ardhura personel, e që lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë objektive të të paditur.

Për gjykatën gjithashtu ishte bindëse edhe shuma e kalkulimit nga eksperti aktuar për kompensim, të cilës i kushtoi besimin e plotë, nga fakti që si rrogë mujore eksperti ka caktuar shumën 250,00 €, pagesa më e ulët që ka ekzistuar për pagesën e shoferëve të autobusëve. Pavarësisht se paditësi ka sqaruar se tek e paditura ka pasur pagën 400,00 €. Mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërteton këtë. Ashtu që gjykata ekspertizës së ekspertit aktuar dhe sqarimeve që paraqiti në seancë i kushtoi besimin e plot.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material për fitimn e humbur ka vendosur sipas shkallës së përgjegjësisë për këtë dëm të shkaktuara të përcaktuara sipas dispozitave të nenit 173, 189, lidhur me nenin 200 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), si dhe duke u bazuar në mendimin e ekspertë aktuar prof. Aziz Berisha.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur, por ka konstatuar se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenin 452 të LPK-së duke e detyruar të paditurën të paguaj shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme 540.80, duke mos i njohur palës paditëse shpenzimet në shumën 11.76 si shpenzimet të e udhëtimit. Pasi që ky lloj i shpenzimeve nuk parashihet në tarifën e odës së avokatëve.

Nga të dhënat e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore të cekura në arsyetimin e këtij aktgjykimi, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C. nr. 1510/2021 datë 01 Mars 2024

Gj y q t a r i,  
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.